

THIRRJE PËR APLIKIM:

Dokumentimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Janjevë

19-23 tetor 2026

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) prej kohësh e ka vlerësuar rolin e të rinjve në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në këtë drejtim, duke filluar nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore të trashëgimisë kulturore me pjesëmarrjen e të rinjve nga radhët e komuniteteve të ndryshme, për t'u mundësuar që të fitojnë përvojë praktike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Këtë vit, kampi rinor për trashëgimi kulturore i OSBE-së do të fokusohet në ***Dokumentimin e aseteve të trashëgimisë kulturore*** që ndodhen në fshatin Janjevë, Komuna e Lipjanit. Në suazat e këtij aktiviteti, **nga 19 deri më 23 tetor 2026**, OSBE do të organizojë një trajnim praktik pesëditor për ***Dokumentimin e aseteve të trashëgimisë kulturore*** për dhjetë (10) studentë universitarë nga radhët e komuniteteve të ndryshme.

Studentët do të mësojnë për historinë e fshatit Janjevë, mënyrat më të mira të dokumentimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, standardet ndërkombëtare, si dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, përfshirë ato arkitekturore, estetike, historike, shoqërore, shpirtërore etj.

Ky kamp pune dedikohet për gjithë studentët e interesuar për promovimin dhe/ose ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Duke ndërthurur mësimin me punë konkrete në terren, studentët do t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre praktike në fushën e trashëgimisë kulturore përmes dokumentimit të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Janjevë. Pjesëmarrja është e hapur për studentë të çdo fakulteti përkatës, por kjo mundësi mund të jetë me interes të veçantë për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencave shoqërore, përfshirë historinë dhe gjeografinë, ose të turizmit. Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme, por jo e domosdoshme, meqë do të sigurohet përkthim në shqip dhe serbisht.

Historiku

Që nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore për trashëgiminë kulturore. Këto kampe u kanë mundësuar të rinjve nga komunitete të ndryshme përfitimin e përvojës së punës praktike në dokumentimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë nën drejtimin e një eksperti ndërkombëtar. Kampet e mbajtura mundësuan plotësimin e mësim-nxënies akademike me njohuri, aftësi praktike dhe shkëmbimin e ideve mes kolegëve gjegjësisht pjesëmarrësve që vijnë nga formime dhe mjedise të ndryshme, duke nxitur kështu ndërveprim dhe bashkëpunim mes të rinjve nga komunitete të ndryshme, promovim të mirëkuptimit dhe respektit për diversitetin kulturor.



Kur dhe ku do të mbahet kampi i punës për trashëgiminë kulturore?

Kampi i punës planifikohet të mbahet në fshatin Janjevë, Komuna e Lipjanit, nga **19** deri më **23 tetor** 2026.

Akomodimi dhe shpenzimet e pjesëmarrësve:

Akomodimi për pjesëmarrësit do të sigurohet nga organizatori.

Misioni i OSBE-së në Kosovë do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për pjesëmarrësit (transportin dhe akomodimin me shujta të plota).

Kush mund të aplikojë?

Të drejtë aplikimi kanë studentët e regjistruar në arsimin e lartë, përfshirë studentët e nivelit master, të cilët kanë interes të theksuar për promovimin dhe/ose ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Pjesëmarrja është e hapur për studentë të çdo fakulteti përkatës, ndërsa kjo mundësi është veçanërisht e përshtatshme për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencave shoqërore, përfshirë gjeografinë dhe historinë, ose turizmit.

Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme, por jo e domosdoshme, meqë do të sigurohet përkthim në shqip dhe serbisht.

Si të aplikoni?

Studentët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në njërën nga gjuhët zyrtare vendore:

- CV¹,
- letër shprehjeje të interesit (maks. 500 fjalë, në Times New Roman 12),
- dëshmi nga fakulteti përkatës që konfirmon statusin e studentit/es dhe fushën e studimit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **27 shtator 2026**.

Aplikimet duhet të dorëzohen me email në Leman.Selimi@osce.org, duke shënuar në rubrikën e titullit (*subject line*): **Kampi i punës për trashëgiminë kulturore**.

Nëse keni nevojë për ndihmë me aplikimin tuaj, kontaktoni Leman Selimin duke dërguar email në adresën Leman.Selimi@osce.org ose duke telefonuar në numrin +383 49 950 198.

¹ Me ofrimin e këtyre të dhënave personale, ju jepni pëlqimin tuaj që Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) t'i përpunojë ato. Këto të dhëna personale mbliidhen vetëm për qëllime të këtij aktiviteti të OMiK-ut dhe nuk do të përpunohen më tej në mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim.

